



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVETËKOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

Në përputhje me autorizimin e dhënë me nenin 17 b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 1 tetor 2001 për ndryshimin e Rregullores 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 të datës 5 tetor 2001 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësve të sigurimit,

Me qëllim zbatimi të nenit 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25,

Këshilli Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 Dhjetor 2005, miratoi:

**Regulla 5 A për licencimin e rregulluesve/mbikëqyrësve të dëmeve të sigurimit të datës 28 Mars 2002**

**Neni 1**

**Marrja e pëlqimit për licencë të ndërmjetësit të sigurimeve**

**1. Zbatimi i rregullës**

Kjo rregull zbatohet për të gjithë aplikuesit që kërkojnë të merren me biznesin e rregulluesit/mbikëqyrësit të dëmeve.

**2. Definicioni i termave:**

Në këtë rregull termat në vijim kanë këtë domethënie:

“Rregulluesi i dëmeve të sigurimit” përfshin rregulluesin e sigurimeve, rregulluesin publik ose vlerësuesin e dëmeve.

“Rregulluesi i sigurimit” është personi i cili, me kompensim, angazhohet për hulumtimin dhe marrjen e informatave për përcaktimin dhe rregullimin e dëmit sipas polisës së sigurimit në emër të siguruesit apo angazhohet për ndihmësrrregullues të sigurimit ose ndihmon siguruesin në ndonjë mënyrë për të përcaktuar dhe rregulluar një dëm të sigurimit.

“Rregulluesi publik” është personi i cili, me kompensim, vepron në emër të të siguruarit apo ndihmon në ndonjë mënyrë të siguruarin në marrëveshjen për rregullimin e një dëmi sipas polisës së sigurimit dhe kërkon punë për rregullimin e këtyre dëmeve.

“I licencuari” është personi i licencuar nga BPK-ja si një rregullues i sigurimeve apo rregullues publik.

“Menaxheri” është personi i cili drejton ose kontrollon veprimtarinë e të licencuarit.

“Personi” përfshin çdo individ, firmë, kompani, shoqatë, organizatë partnership dhe korporatë.

### **3. Personat e përjashtuar nga termi rregullues i sigurimit apo rregullues publik**

Kjo rregull nuk zbatohet ndaj këtyre personave:

- a) Nëpunësit ose punëtorit të BPK-së apo ndonjë zyre tjetër publike ose agjencie të Kosovës derisa është e angazhuar në kryerjen e detyrave zyrtare të saj,
- b) Shoqatës private bëmirëse ose avokaturës e cila mbronë interesin,
- c) Avokat ose kontabilistit publik në ofrimin e shërbimit të tij profesional për klientin e tij apo saj,
- d) Siguruesëve të licencuar, agjentëve, nënagjentëve dhe ndërmjetësëve të tjerë të sigurimeve të cilët kryejnë detyrën e tyre në lidhje me transaksionet e sigurimit,
- e) Nëpunësit që paguhet me rrogë i cili kryen ekskluzivisht punët e zyrës dhe administrative në lidhje me veprimtarinë e parashikuar me këtë rregull,

- f) Fotografët, vlerësuesit, parashikuesit, inxhinierët, arbitrat dhe profesionistët e tjerë të cilët janë të punësuarë nga siguruesi apo rregulluesi për të ofruar ndihmë teknike në rregullimin e dëmeve të sigurimit.

#### 4. Marrja e pëlqimit për licencë të ndërmjetësve të sigurimeve

- a. **Të përshtatshëm dhe të aftë:** Njëra nga kërkesat kryesore për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësit të sigurimeve është që rregulluesi i dëmeve të sigurimit ose aksionari, drejtorët dhe menaxherët e lartë të jenë “të përshtatshëm dhe të aftë” që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre. Në rast se BPK më pas zbulon se ndonjë aspekt i informatave të dhëna në lidhje me kërkesën për licencë të ndërmjetësit të sigurimeve është falsifikuar me qëllim, aksionarët, drejtorët dhe menaxherët e lartë do të dënohen. Në këtë rast kërkesat e tilla refuzohen automatikisht. Në rastet kur licenca është lëshuar në bazë të informatave të falsifikuara, licenca për ndërmjetës të sigurimeve mund të tërhiqet menjëherë.
- b. **Akuzat kriminale:** Aplikantët për të cilët mësohet që kanë qenë të përfshirë në ndonjë aktivitet të mëparshëm që ka rezultuar me akuza kriminale apo fakte të dyshimta, automatikisht do të diskualifikohen nga konsideratat e mëtejshme. Ky diskualifikim do të bëhet për të gjithë kërkuarët e licencës për ndërmjetës të sigurimeve derisa gjykata kompetente e Kosovës t’i lirojë nga akuza.
- c. **Bankrotimi:** Personat që janë deklaruar të bankrotuar nga gjykata kompetente në Kosovë apo diku tjetër janë të diskualifikuar nga konsideratat e mëtejshme. Po kështu do të diskualifikohen nga konsideratat e mëtejshme personat që kanë shërbyer si aksionarë, drejtorë apo menaxherë në ndërmarrjet afariste të bankrotuara.

#### 5. Kërkesat për kualifikim të ndërmjetësve të sigurimeve

Për të shërbyer si agjent, nënagjent apo ndërmjetës, personi duhet të plotësojë kushtet që vijojnë:

- a. **mosha madhore** siç është përcaktuar në Kosovë;
- b. **banor i përhershëm** i Kosovës;

- c. **arsimi** sipas kërkesave të BPK-së;
- d. **standardi profesional** që kërkohet nga BPK-ja;
- e. **integriteti** i padiskutueshëm;
- f. **reputacioni** i shëndoshë;
- g. **burimet financiare** të mjaftueshme për të drejtuar afarizmin si ndërmjetës i sigurimeve.

#### **6. Kërkesat për të gjithë aplikuesit**

- a. **Informatat shtesë:** BPK ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë informata shtesë .
- b. **Gjuha:** Të gjitha kërkesat mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe apo angleze,
- c. **Provizioni për aplikacion:** Një individ që aplikon për licencë për të vepruar si një rregullues i sigurimeve në kompani të sigurimit duhet të paguajë tarifën e pakthyeshme prej 500 euro.

Një individ që aplikon për licencë për të vepruar si rregullues publik duhet të paguajë provizionin e pakthyeshëm të aplikacionit prej 1,500 euro.

Një individ që aplikon për licencë të korporatës, sipas kësaj rregulle, duhet të paguajnë provizionin të pakthyeshëm prej 500 euro. Ky provizioni cili është i ndarë dhe i veçantë nga provizioni për aplikantët individualë.

- d. **Të gjithë aplikantët duhet të sigurojnë këto të dhëna:**
  - d.1. Kërkesën formale për të vazhduar veprimtarinë e ndërmjetësimit të sigurimeve të përgjithshme ose sigurimit të jetës në formën e propozuar nga BPK-ja.
  - d.2. Organogramin origjinal apo dokumentacionin ekuivalent për kompaninë e ndërmjetësve të sigurimeve të propozuar së bashku me statutin e kompanisë apo dokumentacionin ekuivalent (nëse aplikohet);

- d.3. biografinë e plotë(nëse kërkohet) të ndërmjetësit apo aksionarit kryesor kur ata kanë më shumë se 10% të aksioneve të paguara, drejtorët , menaxherët e lartë të propozuar për ndërmjetës të sigurimeve. Në biografi përshkruhet historia profesionale, përgatitja shkollore, përvoja në veprimtarinë e sigurimeve, trajnimi dhe dija. Personi që propozohet për menaxher të lartë duhet të ketë diplomën e biznesit të pranuar nga institucioni kompetent ose kualifikimin përkatës në veprimtarinë e sigurimeve. Dokumentet origjinale të kualifikimit akademik/profesional i dorëzohen BPK-së për shqyrtim. BPK-ja do të verifikojë dëshmitë e ofruara dhe rekomandimet përkatëse;
- d.4. listën e të gjithë individëve me adresat dhe kombësinë e tyre , të cilët janë/do të jenë aksionarë kryesorë të regjistruar apo pronarët e fundit të cilët përfitojnë nga kompania për ndërmjetësime në sigurime. Kjo listë duhet të përfshijë edhe aksionet e secilit aksionar;
- d.5. gjendjen e bilancit personal/raportet për burimet financiare të vërtetuar dhe komplete( nëse kërkohet) për ndërmjetësin apo aksionarin kryesor , drejtorin dhe menaxherët e lartë të propozuar për ndërmjetësime në sigurime. Raportet e mësipërme i vërteton një bankë ose firmë e revizionit e pranuar nga BPK-ja. Çdo përjashtim duhet të aprovohet nga BPK-ja;
- d.6. tri referenca profesionale(nëse kërkohen) për ndërmjetësin apo për secilin aksionar individual , drejtorët dhe menaxherët e lartë të ndërmjetësimin në sigurime. Banka a firma e revizionit e pranuar nga BPK-ja e cila ka vërtetuar raportet e burimeve financiare duhet të ofrojë njërën nga referencat.
- d.7. marrëveshjen e propozuar për agjentë ose ndërmjetës me kompanitë e sigurimit në Kosovë;
- d.8 listën e individëve të punësuar te ndërmjetësi apo ushtruesi i detyrës së ndërmjetësit të sigurimeve me dokumentet e nevojshme për kualifikimet e tyre profesionale dhe akademike;

- d.9. kontratën e qirasë me qiradhënësin që vërteton vendin e biznesit, ku mund të dorëzohen shkresat formale ligjore;
- d.10. Kopja origjinale në lidhje me dëmshpërblimin të propozuar për sigurim.
- d.11. Kopja origjinale e sigurimit të përgjegjësive profesionale, letrës me vlerë ose certifikata e depozitit në lidhje me letrën me vlerë të sigurisë në formën dhe shumën e kërkuar sipas këtyre rregullave.
- d.12. Ndryshimet e rëndësishme të planit të biznesit të dorëzuar nga aplikuesi duhet të miratohen nga BPK. Me një rregull tjetër BPK-ja përcakton çka konsiderohet ndërrim i rëndësishëm. Për mospërbushjen e këtyre kërkesave ndërmerren sanksione të përshkruara në Regulloren mbi sigurimet në Kosovë apo në rregullat e BPK-së.

## **7. Kualifikimet arsimore dhe përvoja për ndërmjetës të sigurimeve**

Sipas kësaj rregulle personi mund të licencohet edhe pa arsimin dhe eksperiencën e duhur duke marrë pjesë në programe intensive të kompanisë siguruese që janë të miratuara nga BPK-ja. Pas tre muaj të trajnimit e tre muaj pune provuese dhe pasi të merret diploma nga zyrtari kompetent i kompanisë së sigurimeve për dituritë teknike dhe shkathtësitë e shitjes, i trajnuari mund të kërkojë licencë të ndërmjetësit nëse i plotëson kërkesat nga pika 1.4 e kësaj rregulle.

BPK mund të kërkojë nga aplikanti të demonstrojë aftësitë e tij teknike si një rregullues i dëmeve të sigurimit si kusht për lëshimin apo mbajtjen e licensës.

## **Neni 2**

### **Kushtet për aplikuesit që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet ndërmjetësve të sigurimeve në Kosovë**

#### **2.1 Kapitali minimal**

Për licencën e një kompanie ndërmjetësuese të sigurimeve në Kosovë duhet të paguhet kapitali minimal prej 5000 euro. BPK-ja do të kërkojë një certifikatë nga banka e autorizuar nga BPK-ja që të vërtetojë se kapitali është paguar apo investimi është bërë në xhirollogarinë e ndërmjetësit.

Për aplikuesit jashtë Kosovës që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari shtesë në Kosovë, BPK-ja do të kërkojë një letër nga mbikëqyrësi i ndërmjetësve të sigurimeve në vendin e origjinës për t'u njohur me qëllimin e aplikuesit lidhur me themelimin e veprimtarinë për ndërmjetësuese të sigurimeve në Kosovë, në të cilën deklarohet se aplikuesi do tu përmbahet ligjeve të sigurimeve në vendin e origjinës duke përfshirë edhe kërkesat në lidhje me aftësitë paguese.

## **2.2 Aplikuesi jashtë Kosovës**

Aplikuesi jashtë Kosovës që dëshiron të themelojë një kompani ndihmëse për ndërmjetësime në sigurime duhet të dorëzojë pasqyrat financiare vjetore të kontrolluara për pesë vitet e fundit në shqipe, serbisht ose anglisht (me përkthimin e vërtetuar në anglisht nëse teksti është në tjetër gjuhë). Bashkë me kërkesën paraqiten llogaritë vjetore për pesë vitet e fundit të kompanisë amë dhe të kompanive tjera që kanë lidhje më të.

Aplikuesi duhet të ketë realizuar fitim së paku katër vjet në pesë vitet e fundit.

## **2. Licenca për korporatë**

- a) Një ndërmjetësi të jashtëm të organizuar si duhet mund t'i jipet licenca për korporatë si rregullues i dëmeve të sigurimit.
- b) Licenca e korporatës duhet t'i përfshijë në listë të gjithë individët e korporatës që kanë plotësuar kushtet dhe janë licencuar sipas kësaj rregulle si rregullues të dëmeve të sigurimit.
- c) Me veprimtarinë e rregullimit të dëmeve mund të merren vetëm individët që gjenden në listën e licencës së korporatës.

## **3. Firma kontrolluese**

BPK-ja zgjedh firmën e licencuar për kontrollin e ndërmjetësit e sigurimeve, e cila duhet të jetë e aftë për ekspertiza të nevojshme në veprimtarinë e sigurimeve.

## **Neni 3**

### **Kushtet për aplikuesit që dëshirojnë të punojnë si degë brenda Kosovës**

#### **3.1 Deklarata nga mbikëqyrësi në juridiksionin e brendshëm**

Nga aplikuesit jashtë Kosovës që dëshirojnë të themelojnë një degë veprimtarie në Kosovë, BPK-ja do të kërkojë një letër nga mbikëqyrësi i ndërmjetësve të sigurimeve në vendin mëmë për t'u njohur me qëllimin e aplikuesit lidhur me themelimin veprimtarisë për ndërmjetësime në sigurime në Kosovë, në të cilën deklarohet se aplikuesi do t'u përmbahet ligjeve të sigurimeve në vendin e origjinës duke përfshirë edhe kërkesat në lidhje me aftësitë paguese.

#### **3.2 Pasqyrat financiare**

Një aplikant jashtë Kosovës që dëshiron të operojë me një degë të kompanisë për ndërmjetësime të sigurimeve duhet të dorëzojë pasqyrat financiare vjetore të kontrolluara për pesë vitet e fundit në gjuhën shqipe, serbe apo angleze (një përkthim i vertetur në anglisht është i pranueshëm). Kur dorëzohet kërkesa, llogaritë vjetore për pesë vitet e fundit të kompanisë mëmë të aplikantit dhe të kompanive tjera që kanë lidhje me të duhet të dorëzohen në të njëjtën gjuhë.

Kërkohet që aplikanti gjatë periudhës pesëvjeçare të ketë punuar së paku katër vjet me fitim.

## **Neni 4**

### **Kushtet për licencimin e rregulluesit/mbikëqyrësit të dëmeve**

#### **1. Kërkesat për licencim**



Asnjë person nuk do të angazhohet në veprimtarinë e parashikuar me këtë rregull, apo të pretendojë të veprojë si i licencuar, përveç nëse është i licencuar në bazë të kësaj rregulle.

## **2. Kualifikimi i menaxherëve**

Asnjë person nuk duhet të veprojë si menaxher i ndërmjetësve përveç nëse posedon licencën për ndërmjetës të sigurimeve të lëshuar në bazë të kësaj rregulle dhe të ketë dëshmuar se teknikisht dhe profesionalisht është i kualifikuar të drejtoj dhe kontrolloj veprimtarinë e ndërmjetësit.

## **3. Informimi**

Ndërmjetësi i licencuar duhet ta informojë BPK-në brenda 30 ditësh nda dita e ndryshimit të kushteve dhe rrethanave si vijon:

- a) Nëse menaxheri ndërpre punën me ndërmjetësin.
- b) Nëse cakton ose pranon menaxher të ri për ndërmjetës.
- c) Çdo ndryshim të emrit ose adresës së ndërmjetësit, apo të aksionarëve kryesorë (nëse posedojnë më shumë se 10% të aksioneve të paguara), nëse është e mundur edhe për drejtorët dhe menaxherët e ndërmjetësit.

## **4. Mostransferimi i licencës**

Licenca e lëshuar në bazë të kësaj rregulle është personale dhe ekskluzivisht e individit të licencuar dhe nuk mund të transferohet.

## **5. Veprimet e ndaluara**

Personi i licensuar në bazë të kësaj rregulle, drejtori, zyrtarët, menaxherët apo të punësuarit duhet të veprojnë si vijon:

- a) Të përhap të ndonjë person, pos me urdhër të gjykatës kompetente ndonjë informatë sekrete, të kërkuar nga klienti lidhur me sbiznesin e tij ose rregullimin e dëmeve të sigurimit.
- b) Të bëjë qëllimisht raport falso për klientin e tij për të cilin janë marrë informatat.

- c) Të dorëzojë raport me shkrim për rregullimin e dëmit i cili nuk është i nënshkruar nga i licencuari, menaxheri i ndërmjetësit apo nga personi i autorizuar. Personi i cili nënshkruan raportin duhet të vërtetojë se faktet dhe informatat e përfshira në raport janë të vërteta dhe korrekte.
- d) Të hyjë në një ndërtesë ose pjesë së saj, apo në një lokal pa pajtimin e pronarit apo personit i cili është posedues ligjor i asaj ndërtese apo lokali.
- e) Të merr beneficione financiare nga riparuesi I automjeteve, agjenti, nenagjent apo ndërmjetësi.
- f) Të mos paraqes interesin e tij apo saj të plotë financiar në një kontratë apo marrëveshje për rregullimin e një dëmi para realizimit të saj.
- g) Të bëjë ndonjë keqreprezentim për të joshur ndonjë kontratë për rregullimin e dëmit.
- h) Të ketë ndonjë interes kapitali në ndonjë firmë e cila pranon punën në lidhje me një dëm të sigurimit për të cilin ka kontratë apo marrëveshje për ta rregulluar.
- i) Ka ndonjë interes për të pranuar beneficione në para nga riaftësimi I ndonjë pasurie në lidhje me një dëm të sigurimit në të cilin ai apo ajo ka kontratë apo marrëveshje për ta rregulluar.
- j) Të kontraktojë apo hyjë në marrëveshje për të rregulluar ndonjë dëm të sigurimit për të cilin kompensimi i tij është përqindja e shumës për të cilën dëmi rregullohet.

## **Neni 5**

### **Revokimi i licencës për ndërmjetës të sigurimeve**

Për dhënien e licencës aplikanti duhet të sigurojë BPK-në se do t'i plotësojë të gjitha kushtet e kërkuara. Licenca e dhënë mund të revokohet në rastet që vijojnë:

- kur aplikanti pa lejen e BPK-së ndryshon ndonjërin nga faktorët që përbëjnë integritetin e tij si ndërmjetës i sigurimeve;

- kur ndërmjetësi i porsalicencuar i sigurimeve cenon seriozisht rregullat e sigurimeve të miratuara nga BPK-ja;
- kur shkel ligjin penal të shpallur nga qeveria ose ndonjë organ tjetër qeveritar i Kosovës;
- nëse ndërmjetësi i sigurimeve nuk ka filluar veprimtarinë brenda gjashtë muajsh nga data e marrjes së licencës.

## **Neni 6**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi me datë 01 Janar 2006.

Michel Svecine  
Drejtore i Përgjithshëm